



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 29 prill 2021
Nr. ref.:RK1759/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI185/20

Parashtrues

“ENA” SH. A.

Kërkesë për kthimin në gjendje të mëparshme të “çështjes së përfunduar” me Vendim për refuzim në rastin KI104/19, të 16 janarit 2020 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; dhe

kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktvendimit [AC-I-19- 0013] të 28 shkurtit 2019 të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Fabrika e enëve “ENA” sh. a., të cilën e përfaqëson drejtori i saj Ruzhdi Kumnova, me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës kërkon vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit [AC-I-19- 0013] të 28 shkurtit 2019 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: DHPGJS).

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës kërkon kthimin në gjendje të mëparshme të “çështjes së përfunduar” me Vendim për refuzim në rastin KI104/19, të 16 janarit 2020 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
4. Ndërsa përkitazi me aktvendimin e kontestuar të DHPGJS-së, parashtruesi i kërkesës pretendon se atij i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 47 (Kërkesa individuale) dhe 50 (Kthimi në gjendjen e mëparshme) të Ligjit dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 9 dhjetor 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 30 dhjetor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
8. Më 14 janar 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 13 prill 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të refuzohet kërkesa e parashtruesit të kërkesës për kthimin në gjendje të mëparshme të “çështjes së përfunduar” me Vendim për refuzim në rastin KI104/19, të 16 janarit 2020 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe konstatoi që kërkesa e parashtruesit

është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.

Përkitazi me procedurën para Gjykatës në rastin KI104/19

10. Më 20 qershor 2019, parashtuesi i kërkesës kishte dorëzuar kërkesën në Gjykatë, përmes të cilës kërkohej vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [AC-I-19-0013] të 28 shkurtit 2019 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, përmes të cilit pretendoi se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës.
11. Parashtuesi i kërkesës në kërkesën e tij të parashtuar në Gjykatë, nëpërmjet postës, nuk kishte (i) dorëzuar formularin e plotësuar të Gjykatës për kërkesa individuale dhe po ashtu nuk kishte dorëzuar (ii) autorizimin e vlefshëm që dëshmon se e përfaqëson fabrikën “ENA” në Gjakovë ashtu siç kërkohet me rregullin 32 (1) dhe (3) të Rregullores së punës.
12. Më 29 korrik 2019, në mungesë të adresës së shënuar nga parashtuesi i kërkesës në kërkesën e tij (ashtu siç kërkohet me rregullin 32 (2) (a) të Rregullores së punës) dhe të një numri kontaktues (siç kërkohet në formularin e kërkesës për kërkesa individuale), Gjykata kërkesën e saj për (i) dorëzimin e formularit të plotësuar të Gjykatës për kërkesa individuale dhe të (ii) autorizimit për përfaqësim në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh e kishte dorëzuar në adresën [e selisë së Fabrikës “ENA”, rruga “Nënë Tereza”, p. nr. Gjakovë], e cila adresë ishte e shënuar edhe në padinë e dorëzuar në emër të Fabrikës “ENA” në DHPGJS, të 22 janarit 2012, dhe Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar [SCC-08-0243] të 16 tetorit 2018 të DHPGJS-së [dokumente të bashkëngjitur në kërkesën KI104/19].
13. Në bazë të fletëkthesës, të pranuar në Gjykatë më 1 gusht 2019, dëshmohet se Njoftimi i Gjykatës, i 29 korrikut 2019 ishte dorëzuar në adresën e lartshënuar [rruga “Nënë Tereza”, p. nr. Gjakovë]. Megjithatë, Gjykata nuk kishte pranuar dokumentet e kërkuara për plotësimin e kërkesës.
14. Më 21 tetor 2019, Gjykata i kishte dërguar sërish shkresë parashtuesit të kërkesës dhe kishte kërkuar nga ai që në afat prej 7 (shtatë) ditësh të dorëzojë (i) autorizimin e kërkuar me shkresën e 29 korrikut 2019 si dhe (ii) formularin e plotësuar të Gjykatës për kërkesat individuale.
15. Në bazë të fletëkthesës së pranuar në Gjykatë, dëshmohet se Njoftimi i Gjykatës, i 21 tetorit 2019 ishte dorëzuar në adresën e lartshënuar [rruga “Nënë Tereza”, p. nr. Gjakovë]. Gjykata sërish nuk kishte pranuar dokumentet e kërkuara përmes shkresës së saj, të 21 tetorit 2019.
16. Rrjedhimisht, si rezultat i mospranimit të dokumenteve të kërkuara nga z. Ruzhdi Kumnova, në cilësinë e tij si përfaqësues i pretenduar, më 16 janar 2020,

Gjykata vendosi që kërkesën në rastin KI104/19 ta refuzojë me procedurë të shkurtër ashtu siç është përcaktuar me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës. Gjykata në Vendimin e saj për refuzim KI104/19, arsyetoi se “Mosdorëzimi i autorizimit të vlefshëm në Gjykatë i pamundëson Gjykatës shqyrtimin e një kërkesë në pajtim me nenin 21 të Ligjit dhe rregullit 32 të Rregullores së punës” dhe konkludoi se “[...] kërkesa është e paplotë dhe nuk është e qartësuar sepse përfaqësuesi i pretenduar [Ruzhdi Kumnova] nuk kishte dorëzuar në Gjykatë autorizimin e vlefshëm për përfaqësimin e palës të cilin ai pretendon se e përfaqëson para Gjykatës”.

17. Më 25 qershor 2020, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesë për urgjencë në lidhje me rastin KI104/19. As në kërkesën e tij për urgjencë, nuk ishte vendosur adresa apo numri kontaktues.

Përkitazi me faktet që ndërlidhen me Aktvendimin e kontestuar [AC-I-19-0013] të 28 shkurtit 2019 të DHPGJS-së

18. Në bazë të shkresave të lëndës të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës rezulton që procedura e zhvilluar pranë DHPGJS-së ndërlidhet me një procedurë paraprake, respektivisht kërkesën e parashtruesit për caktimin e masës së përkohshme.
19. Më 25 janar 2018, parashtruesi i kërkesës në DHPGJS kishte parashtruar padi të re për anulimin e Vendimit [nr. ref. BD 97/16] të 25 shtatorit 2017, të Bordit të Drejtorëve të AKP-së përmes të cilit parashtruesi i kërkesës ishte futur nën administrimin e Agjencisë Kosovare për Privatizim (në tekstin e mëtejme: AKP).
20. Më 25 shtator 2018, parashtruesi i kërkesës kishte parashtruar kërkesë përmes të cilës kishte kërkuar caktimin e masës së përkohshme, në mënyrë që të pezullohet ekzekutimi i Vendimit [nr. ref. BD 97/16] të 25 shtatorit 2017 të Bordit të Drejtorëve të AKP-së.
21. Më 16 tetor 2018, gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së përmes Aktvendimit [SCC-08-0243] caktoi masën e përkohshme dhe pezulloi zbatimin e Vendimit të lartcekur të Bordit të Drejtorëve të AKP-së, deri në vendosjen e meritave të rastit.
22. Kundër aktvendimit të lartcekur, AKP, në cilësinë e të paditurës kishte parashtruar ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së.
23. Më 5 dhjetor 2018 dhe më 7 dhjetor 2018, respektivisht, avokati i parashtruesit të kërkesës dhe parashtruesi i kërkesës ndaras kishin dorëzuar përgjigje ndaj ankesës të AKP-së. Parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar që Aktvendimi [SCC-08-0243] i 16 tetorit 2018 përmes të cilit ishte caktuar masa e sigurisë të mbetet në fuqi.
24. Më 20 dhjetor 2018, Kolegji i Apelit përmes Aktvendimit [AC-I-18-0548], ankesën e AKP-së e aprovoi si të bazuar dhe ndryshoi Aktvendimin [SCC-08-0243] të 16 tetorit 2018, të gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të Kolegjit të Specializuar, dhe për pasojë shfuqizoi masën e përkohshme.

25. Më 24 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës në Kolegjin e Ankesave në DHPGJS kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim dhe përsëritje të procedurës ndaj Aktvendimit [AC-I-18-0584] të 20 dhjetorit 2018, të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së.
26. Më 28 shkurt 2019, Kolegji i Apelit të DHPGJS-së përmes Aktvendimit [AC-I-19-0013] kishte hedhur poshtë si të papranueshme kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim dhe përsëritje të procedurës ndaj Aktvendimit të Kolegjit të Apelit AC-I-18-0584, të 20 dhjetorit 2018.
27. Parashtruesi i kërkesës kopjet e Aktvendimit të kontestuar [AC-I-19-0013] të 28 shkurtit 2019 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së; të kërkesës së tij për rishqyrtim dhe përsëritje të procedurës ndaj Aktvendimit të Kolegjit të Apelit [AC-I-18-0584] të 24 dhjetorit 2018; të Aktvendimit [SCC-08-0243], të 16 tetorit 2018 të Kolegjit të Specializuar; dhe të padisë së tij në DHPGJS të 20 qershorit 2019, i ka dorëzuar në kërkesën e tij të regjistruar në Gjykatë, me numër KI104/19.

Kërkesa e parashtruesit të kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme

28. Parashtruesi i kërkesës kërkon lejimin e kthimit në gjendje të mëparshme të kërkesës së tij KI104/19, përmes të cilës kishte kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit [AC-I-19-0013] të 28 shkurtit 2019 të DHPGJS-së.
29. Parashtruesi i kërkesës pohon se më *“18 qershor [2019] përmes postës së Kosovës në cilësinë e Drejtorit të Fabrikës “ENA”, sh. a. Gjakovë asaj Gjykate [Gjykatës Kushtetuese] i kam parashtruar kërkesë – ankesë kushtetuese, për shkak të shkeljeve kushtetuese të cilat i janë shkelur parashtrueses së kërkesës, në bazë të Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështje që lidhet me AKP-në AC-I-190013 të datës 28.02.2019”*.
30. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës pohon se *“Kërkesës sipas bindjes sime i kam bashkëngjitur të gjithë dokumentacionin që kam vlerësuar se është i nevojshëm për të mundur ajo Gjykatë e Nderuar që të vendosë”*.
31. Në vijim, parashtruesi i kërkesës thekson se *“pas paraqitjes së kërkesës kam ushtruar edhe urgjencë për vendosje sipas kërkesës së cituar” dhe “Kam pritur përgjigjen përkatëse nga Gjykata”*.
32. Parashtruesi i kërkesës arsyeton se në lidhje me Vendimin për refuzim të 16 janarit 2020 të Gjykatës është njoftuar përmes ueb-faqes së Gjykatës.
33. Në lidhje me përmbajtjen e Vendimit për refuzim në rastin KI104/19, parashtruesi i kërkesës pohon se si *“parashtrues i kërkesës nuk kam marrë asnjë nga dërgesat postare që i ka cekur Gjykata në pikën 7 dhe 8 të vendimit të Gjykatës rasti KI104/19”*. Në kontekst të kësaj, parashtruesi i kërkesës thekson se *“Dërgesat postare [kërkesa e Gjykatës e 29 korrikut 2019 dhe 21 tetorit 2019, respektivisht] kanë mundur që t’i marrin persona të paautorizuar, të pakualifikuar, që edhe po t’iu kenë rënë në dorë dërgesat postare, ato t’i kenë*

asgjësuar. Është notore se fabrikat dhe ndërmarrjet për shkak të ndryshimit të rrethanave nuk kanë punuar dhe në Fabrikë kanë mundur të jenë rojet fizike. Andaj, duke paraqitur këtë kërkesë, kërkoj që Gjykata të lejoj kthimin në gjendje të mëparshme, që dërgesat postare t' i adresoj në adresën Ruzhdi Kumnova, rr. "Marin Barleti", Hyrja II, nr. 19".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me Aktvendimin [AC-I-19- 0013] të 28 shkurtit 2019 të DHPGJS-së

34. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij para Gjykatës pretendon se Aktvendimi [AC-I-19- 0013] i 28 shkurtit 2019 të DHPGJS-së, i ka shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës.
35. Në kërkesën e tij, ndër të tjera, parashtruesi i kërkesës kërkon si në vijim: *"[...] lusim Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, që të kërkoj nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, t' i dorëzohet lënda së bashku me të gjitha shkresat e sajë, Gjykatës Kushtetuese, me qëllim të vlerësimit të shkeljeve kushtetuese të bëra nga ajo Gjykatë".*
36. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon që *"[...] në radhë të parë që të lejohet kthimi në gjendje të mëparshme. Përfundimisht me vendimet e atakuara me këtë kërkesë janë cenuar edhe të drejtat e mia personale si aksionar në Fabrikën në fjalë".*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

37. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
38. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]*

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

39. Gjykata gjithashtu i referohet paragrafit 4, të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, i cili përcakton: *"Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme".*
40. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, në cilësinë personit juridik ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese,

duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës KI41/09, parashtruesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).

41. Gjykata gjithashtu më tej i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç specifikohen më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individit mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...].”

42. Në lidhje me të lartcekurat, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [AC-I-19- 0013] e 28 shkurtit 2019 të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Në kërkesën e tij të tanishme, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës ka dorëzuar një certifikatë të regjistrimit të biznesit në Agjensionin e Regjistrimit të Biznesit të Kosovës në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, [e lëshuar më 16 dhjetor 2016] dhe vendimet e Këshillit Drejtues të Kompanisë për emërimin e tij si Drejtor i fabrikës “ENA” sh. a., të 26 janarit 2015 dhe 20 marsit 2020.
43. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se përtej kriterit 4 (katër) mujor të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit për parashtrimin e kërkesave para Gjykatës sipas procedurës të përcaktuar përmes paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, përkatësisht kërkesave individuale, është gjithashtu pika (c) e paragrafit (1) të rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës, i cili përcakton si në vijim:

Rregulli 39

(Kriteret e pranueshmërisë)

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit, dhe [...].”

44. Në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [AC-I-19- 0013] e 28 shkurtit 2019, të cilin Aktvendim parashtruesi i kërkesës e kishte kontestuar edhe në kërkesën e tij, të dorëzuar në Gjykatë më 18 qershor 2019 dhe të regjistruar në Gjykatë me numër KI104/19. Rrjedhimisht, nuk është kontestuese se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është dorëzuar pas afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të punës.
45. Në lidhje me sa më sipër, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata kthimin në gjendjen e mëparshme të kërkesës së tij KI104/19, i cili rast është shqyrtuar dhe gjykuar nga Gjykata përmes Vendimit për refuzim, të 16 janarit 2020. Në vijim të kërkesës së tij për kthim në gjendje të mëparshme, parashtruesi i kërkesës në mënyrë specifike kërkon që të shqyrtohet kërkesa e tij e dorëzuar më 18 qershor 2019, përmes të cilës ishte kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [AC-I-19- 0013] të 28 shkurtit 2019 të DHPGJS-së.
46. Në kontekst të kërkesës së parashtruesit të kërkesës për kthim të afatit në gjendje të mëparshme, Gjykata fillimisht rikujton përmbajtjen e nenit 50 (Kthimi në gjendjen e mëparshme) të Ligjit, i cili përcakton si në vijim:

“Nëse parashtruesi pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, Gjykata Kushtetuese ka për detyrë që në bazë të kërkesës së parashtruesit ta kthejë atë në gjendjen e mëparshme. Parashtruesi ka për detyrë të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve që nga mënjanimi i pengesës dhe të arsyetojë kërkesën në fjalë. Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet nëse ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj”.

47. Bazuar në përmbajtjen e nenit 50 të Ligjit, në mënyrë që të aprovohet kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme, duhet të plotësohen kushtet në vijim: (i) parashtruesi i kërkesës duhet të dëshmojë se pa fajin e tij/saj nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar, përkatësisht afatit 4 (katër) mujor të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit; (ii) parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve që nga mënjanimi i pengesës; (iii) parashtruesi i kërkesës duhet të arsyetojë kërkesën në fjalë; dhe (iv) nuk ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me Ligj për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë. Këto kushte janë kumulative (shih rastin e Gjykatës, KI163/20, parashtrues *“Inter-Eminex”*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 shkurtit 2021, paragrafi 48).

48. Në rrethanat e rastit konkret dhe siç është sqaruar më lart, Gjykata rikujton se kërkesën e parashtruesit të kërkesës, të regjistruar në Gjykatë me numër KI104/19 e kishte refuzuar me procedurë të shkurtër bazuar në rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, duke konstatuar se kërkesa e tij ishte e paplotë, si rezultat i asaj që parashtruesi i kërkesës nuk ishte përgjigjur në kërkesat e Gjykatës, të 29 korrikut 2019 dhe 21 tetorit 2019, respektivisht për (i) plotësimin e formularit të kërkesave individuale dhe (ii) dorëzimin e autorizimit për përfaqësim.
49. Në kërkesën e tij të tanishme, parashtruesi i kërkesës pohon se nuk i ka pranuar kërkesat e Gjykatës, përmes të cilave i është kërkuar autorizimi për përfaqësim dhe rrjedhimisht kërkon kthimin në gjendjen e mëparshme të kërkesës KI104/20. Megjithatë, Gjykata duke u bazuar në shkresat e lëndës, të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij KI104/19, të 18 qershorit 2019 rikujton se në kërkesë nuk ishte vendosur apo shënuar adresa (ashtu siç kërkohet me rregullin 32 (2) (a) të Rregullores së punës), në të cilën Gjykata mund ta kontaktonte atë dhe të njoftonte në lidhje me kërkesën e tij. Megjithatë, me qëllim të kompletimit të kërkesës së tij me dokumentet përkatëse, të cilat ishin të domosdoshme për vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës së tij, më 29 korrik 2019, Gjykata i dërgoi parashtruesit të kërkesës kërkesën e saj për (i) dorëzimin e formularit të plotësuar të Gjykatës për kërkesa individuale dhe të (ii) autorizimit për përfaqësim në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh. Këtë kërkesë të saj, Gjykata në mungesë të shënimit të adresës kontaktuese, e kishte dorëzuar në adresën e selisë së Fabrikës “ENA” [rruga “Nënë Tereza”, p. nr. Gjakovë], e cila adresë ishte e shënuar në padinë e dorëzuar në emër të Fabrikës “ENA” në DHPGJS, të 22 janarit 2012, dhe Aktvendimin [SCC-08-0243] të 16 tetorit 2018 e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së [dokumente të bashkëngjitur në kërkesë].
50. Gjykata, më tej rikujton se në bazë të fletëkthesës, të pranuar në Gjykatë më 1 gusht 2019, dëshmohet se Njoftimi i Gjykatës, i 29 korrikut 2019 ishte dorëzuar në adresën e lartshënuar [rruga “Nënë Tereza”, p. nr. Gjakovë]. Megjithatë, Gjykata nuk kishte pranuar dokumentet e kërkuara për plotësimin e kërkesës. Për pasojë, më 21 tetor 2019, Gjykata i kishte dërguar sërish shkresë parashtruesit të kërkesës dhe kishte kërkuar nga ai që në afat prej 7 (shtatë) ditësh të dorëzojë dokumentet e kërkuara nga Gjykata përmes shkresës së 29 korrikut 2019. Sërish, në bazë të fletëkthesës së pranuar në Gjykatë, dëshmohet se Njoftimi i Gjykatës, i 21 tetorit 2019 ishte dorëzuar në adresën e lartshënuar [rruga “Nënë Tereza”, p. nr. Gjakovë], dhe në vijim të kësaj Gjykata sërish nuk kishte pranuar dokumentet e kërkuara edhe përmes shkresës së saj, të 21 tetorit 2019.
51. Gjykata rikujton që si pasojë e mosdorëzimit të dokumenteve të kërkuara nga Gjykata, më 29 korrik 2019 dhe 21 tetor 2019, respektivisht, më 16 janar 2020, vendosi që kërkesën, në rastin KI104/19, ta refuzojë me procedurë të shkurtër ashtu siç është përcaktuar me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës. Gjykata në Vendimin e saj për refuzim KI104/19 arsyetoi se “Mosdorëzimi i autorizimit të vlefshëm në Gjykatë i pamundëson Gjykatës shqyrtimin e një kërkesë në pajtim me nenin 21 të Ligjit dhe rregullit 32 të Rregullores së punës” dhe

konkludoi se “ [...] kërkesa është e paplotë dhe nuk është e qartësuar sepse përfaqësuesi i pretenduar [Ruzhdi Kumnova] nuk kishte dorëzuar në Gjykatë autorizimin e vlefshëm për përfaqësimin e palës të cilin ai pretendon se e përfaqëson para Gjykatës”.

52. Gjykata rithekson se Gjykata ka detyrë të miratojë ose jo kthimin në gjendje të mëparshme të afatit, bazuar në vlerësimin e saj, në secilin rast veç e veç, nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara në nenin 50 të Ligjit dhe të cilat janë kumulative. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se neni 50 i Ligjit i referohet kërkesave të parashtruesve të kërkesës me rastin e dorëzimit të një kërkesë në Gjykatë, përmes të cilës kërkohet edhe kthimi i afatit në gjendje të mëparshme në rast se këta të fundit mund të mbështesin kërkesën e tyre duke plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara përmes nenit 50 të Ligjit.
53. Përderisa në rastin konkret, Gjykata ripërsëritë se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tanishme kërkon që të kthehet afati i kërkesës së tij të dorëzuar më 18 qershor 2019 në Gjykatë, e regjistruar me numër KI104/19, duke arsyetuar se ai nuk ka pranuar kërkesat e Gjykatës për plotësimin e kërkesës së tij, të dorëzuara më 29 korrik 2019 dhe 21 tetor 2019.
54. Gjykata duke iu referuar elaborimit si më sipër, në veçanti shkresave të lëndës të dorëzuara në kërkesën e tij, të regjistruar me numër KI104/19 dhe arsyetimit të tij të dhënë në kërkesën e tij të tanishme, përmes të cilës kërkon në mënyrë specifike kthimin në gjendje të mëparshme të kërkesës së tij KI104/19, vlerëson se kjo kërkesë nuk plotëson kushtet e sipërcekura të përcaktuara përmes nenit 50 të Ligjit. Në këtë kontekst, Gjykata bazuar në shkresat e lëndës në rastin KI104/19 dhe sqarimit të tij të dhënë në kërkesën e tanishme vlerëson se parashtruesi i kërkesës (i) nuk ka dëshmuar se pa fajin e tij nuk ka qenë në gjendje të parashtrojë kërkesën brenda afatit të përcaktuar përmes nenit 49 të Ligjit; (ii) dhe rrjedhimisht nuk ka arritur që të arsyetojë kërkesën e tij për kthim në gjendje të mëparshme; (iii) nuk ka dëshmuar se ka paraqitur kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga mënjanimi i pengesës; dhe (iv) ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me Ligj për paraqitjen e kërkesës në Gjykatë. Në veçanti, në lidhje me kriterin e fundit, i përcaktuar me nenin 50 i Ligjit, dhe i cili specifikon që “*Kthimi në gjendjen e mëparshme nuk lejohet nëse ka kaluar një vit ose më shumë nga dita kur ka përfunduar afati i përcaktuar me këtë ligj*”, Gjykata mosplotësimin e këtij kriteri e arsyeton me faktin se kërkesa e tij KI104/19, është dorëzuar më 18 qershor 2019, përmes të cilës është kërkuar vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [AC-I-19- 0013] e 28 shkurtit 2019 të DHPGJS-së, përderisa kërkesën e tij të tanishme, parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar më 9 dhjetor 2020.
55. Bazuar në elaborimin e mësipërm dhe konstatimin e saj, se nuk janë plotësuar asnjëri nga kushtet e përcaktuara në nenin 50 të Ligjit për kthim në gjendje të mëparshme, dhe rrjedhimisht duhet të konstatojë se kërkesa është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar në nenin 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 21.4 dhe 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20, 49 dhe 50 të Ligjit dhe rregullave 39 (1) (c) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 13 prill 2021, njëzëri:

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën e parashtruesit për kthim në gjendje të mëparshme;
- II. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi